



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI I MINISTRAVE  
AGJENCIA E PROKURIMEVE PUBLIKE**

**DOKUMENTAT E PROCEDURËS KONKURRUESE TË  
KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT PËR  
PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN,  
MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E AEROPORTIT TË  
SARANDËS (SIA)**

## NJOFTIMI I KONTRATËS

### I. Autoriteti Kontraktor

#### I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri                               Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  
Adresa                            Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1001, Tiranë  
Tel/Fax                            +355 4 22222245  
Adresa e Internetit            [www.infrastruktura.gov.al](http://www.infrastruktura.gov.al)

#### I.2 Emri dhe adresa e personit përgjegjës:

Emri                                Teuta Balili  
Adresa                            Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  
E-mail                            [teuta.balili@infrastruktura.gov.al](mailto:teuta.balili@infrastruktura.gov.al)

Emri                                Kledia Ngjela  
Adresa                            Ministria e Infrastruktures dhe Energjise  
E mail                            kledia.ngjela@infrastruktura.gov.al

#### I.3 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

|                                     |                          |
|-------------------------------------|--------------------------|
| Institucion qëndror                 | Institucion i pavarur    |
| <input checked="" type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Njesite e Qeverisjes Vendore        | Tjetër                   |
| <input type="checkbox"/>            | <input type="checkbox"/> |

## II. Objekti i kontratës

Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit te Sarandës

### II.1 Lloji i Kontratës

|                                     |                          |
|-------------------------------------|--------------------------|
| Punë                                | Shërbime                 |
| <input checked="" type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

### II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat

- Objekti i kontratës                               Dhënie me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit

të Sarandës

2. Forma e kontratës Kontratë Koncesioni / PPP
3. Burimi i financimit Shoqëri Tregtare private ose Bashkim i tyre / Kapital privat
4. Vlera e parashikuar e projektit: 34,320,000 Euro (Pa TVSH)
5. Kohëzgjatja e kontratës : 35 vjet

### II.3 Kohezgjatja e kontrates ose afati kohor per ekzekutimi:

Kohezgjatja ne muaj 420 muaj.

### II.4 Vendndodhja e objektit te kontratës:

Aeroporti i Sarandes ndodhet ne zonen sipas hartes se bashkangjitur, te Sarandes.

## III. Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

### III.1 Kriteret e Pranimit sipas Shtojcës Nr. 9

### III.2 Sigurimi i ofertës: (i zbatueshem ne rastin e procedurave te prokurimit me vlere me te larte se kufiri i larte monetar, ne rast se kerkohet nga Autoriteti Kontraktor)

Që një Operator Ekonomik të marrë pjesë në një procedurë koncesioni/partneritetit publik privat, kërkohet që të paraqesë Sigurimin e Ofertës, shoqëruar me Formularin e Sigurimit të Ofertës, që gjendet në Shtojcën 3.

Vlera e kerkuar e sigurimit te ofertes eshte 2% e vleres se investimit te propozuar (dy perqind e vleres se propozuar te investimit)

## IV. Procedura

### IV.1 Lloji i procedurës:

|                                     |                          |                                   |
|-------------------------------------|--------------------------|-----------------------------------|
| E hapur                             | E kufizuar               | Me negociim me shpallje paraprake |
| <input checked="" type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/>          |

### IV.2 Kriteret e për zgjedhjes së fituesit:

Lidhur me rëndësinë:

| Nr. | Kriteret  | Pikët |
|-----|---|-------|
| 1   | Përmbledhja e shkurtër dhe arsyetimi strategjik i projektit duke përfshirë: | 34    |
| A   | Plani i zonimit te tokes sipas faciliteteve te aeroportit                   | 18    |

| Nr. | Kriteret   | Pikët |
|-----|--|-------|
|     | B Zgjidhje me Vlerë të Shtuar  | 10    |
|     | C Përgjegjësia Sociale:  | 6     |
| 2   | Përvojë ne Projekte Ndërtimi dhe/ose Renovimi i të paktën 1 (një) aeroporti ku rinovimi konsiston në terminalin e pasagjereve; pista dhe vendqendrimi (Kategoria 3C ose me lart), gjatë 10 (dhjetë)viteve të fundit, me kapacitet 1 (një) milion pasagjerë ose më shumë. | 10    |
| 3   | Përvoja e Operimit dhe Mirëmbajtjes (O&M)  | 9     |
| 4   | Përvoja mbi përftimin e financimeve  | 10    |
| 5   | Rritja e Nr. Pasagjerëve   | 14    |
| 6   | Tarifë Koncesionare  | 12    |
| 7   | Koha e vënies në operim  | 11    |

### **IV.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave:**

Brenda dhe jo me vonë se: Data: **26/11/2021 Ora: 12:00 CET**

**Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)**

### **IV.4 Afati kohor për hapjen e ofertave:**

**V. Brenda dhe jo me vonë se: Data: 26/11/2021 Ora: 12:00 CET**

Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me mjete elektronike.

**Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të ofertave, qe paraqiten me mjete elektronike duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre.**

### **V.1 Periudha e vlefshmërisë së ofertave 150 ditë**

### **V.2 Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:**

Shqip                Anglisht           

### **VI. Informacione plotësuese**

#### **VI.1 Dokumenta me pagesë:**

Po                        Jo                   

Vlera e tarifës që duhet të paguhet nga operatori ekonomik në rast të një ankese pranë Komisionit të Prokurimit Publik është 10% e vlerës së Sigurimit të Ofertës.

**VI.2** Vlera e tarifës së ATRAKO, referuar nenit 12 të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin publik Privat” të ndryshuar, është Shuma që do të paguhet për shërbimet e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) dhe paguhet nga koncesionari fitues sipas VKM 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”.

#### **VI.3 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)**

---

---

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi **26/10/2021**

## UDHËZIME PËR OFERTUESIT

### 1. HYRJE

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka vendosur të implementojë projektin “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Sarandës (SIA) nga Koncesionari te AK”. Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues do të bëhet në bazë të një procedure konkurruese të hapur, sipas kritereve kualifikuese dhe vlerësuese të specifikuara në këtë dokument. Kohëzgjatja e kontratës koncesionare/ PPP është 35 vite nga hyrja në fuqi e saj.

Vënia në punë e Aeroportit të Sarandës është një nga angazhimet kryesore të Qeverisë Shqiptare.

Aeroporti i ri ne Sarandë do te ndertohet ne perputhje me ligjet, standardet dhe rregulloret kombetaredhe nderkombetare ne fuqi. Nderkohe do te adoptohen dhe rregulloret per mbajtjen e kerkesave te sigurise teknike persa i perket operimeve ne ajer dhe ne toke dhe mbi te gjitha per marrjen dhembajtjen e certifikates se aeroportit.

Parashtruar edhe në Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016–2020, miratuar me VKM Nr. 811, datë 16.11.2016.

Sipas kësaj Strategjie, sfidat kryesore në sektorin ajror për periudhën e planifikimit 2016-2020 lidhen me “krijimin e kushteve të përshtatshme për një treg më konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara që do të sjellin mundësinë e një reduktimi në shpenzimet e udhëtimit për pasagjerët”. Strategjia vijon duke parashtruar objektivat strategjike për transportin ajror deri në vitin 2020:

- Shqipëria duhet të bëhet konkurruese në tregun e transportit ajror për të siguruar lidhje të drejtpërdrejta me aeroportet kryesore evropiane në mënyrë që të rrisë fluksin e pasagjerëve për në dhe nga Shqipëria.
- Vëmendje ndaj cilësisë së shërbimeve, efikasitetit të operacioneve, roleve sociale në proporcion me kërkesat e transportit.
- Aeroportet shërbejnë si promotore dhe kontributor potencial për nivelin e sektorit të turizmit në rajon.

Për sa më sipër, vijimi me zbatimin e objektivave strategjik, me vënien në punë të Aeroportit të Sarandës, pritshmëria është që ky aeroport të ketë një ndikim të konsiderueshëm ekonomik, social dhe kulturor, në zhvillimin e kësaj zone, duke bërë të mundur hapjen e vendeve të reja të punës, zhvillimin e turizmit, ofrimin e shërbimeve ajrore për transportuesit me kosto të ulët, cka do të sjelli dhe uljen e tarifave të biletave për udhëtime ndërkombëtare për qytetarët.

## 1.1 Informacion i mëtejshëm:

### Përshkrim i përgjithshëm

#### a. POZICIONI GJEOGRAFIK

Aeroporti i Sarandës ndodhet rreth 6 km larg qytetit të Sarandës, pranë rrugës nacionale, 20 m mbi nivelin e detit. Në perimetrin e zonës së projektit të distancuar prej tij ndodhen fshatrat Cukë, Caush, Aliko, Neohor, Dritas, Plaga e Re, Skate. Nga ana perëndimore, zona e projektit kufizohet me kodrat ku shtrihet fshati “Lekures” me këstjellë në tij dhe përtej kodrave shtrihet qyteti i Sarandës. Lumi Bistrica përshkon zonën e projektit përgjatë kësaj ane. Në anën jugore kufizohet nga Liqeni i Butrintit.




Figura 11: Vendndodhja e Aeroportit të Ri - Sarandë

#### b. KUSHTET AKTUALE

Projekti i aeroportit të Sarandës do të jetë një investim greenfield.

#### c. LIDHJA E AEROPORTIT ME INFRASTRUKTURËN EKZISTUESË

Përveç infrastrukturës në aeroport, është shumë e rëndësishme që të ketë një lidhje të mirë rrugore midis qytetit, autostradës dhe aeroportit për të siguruar që udhëtarët do të vijnë në kohë në aeroport nga njëra anë dhe nga ana tjetër për të rritur zonën e mbulimit të aeroportit.

#### d. KUSHTE TË TJERA TË LIDHURA ME OBJEKTIN

- 1.2 Projekti për ndërtimin e aeroportit të Sarandës është propozimi i kërkuar i miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- 1.3 Në momentin që ofertuesi fitues prezanton projektin dhe masterplanin e tij, Autoriteti Kontraktor është përgjegjës për shpronësimet dhe vlerën e tyre brenda zonës së ndërtimit të aeroportit, e cila do të kryhet nga Agjencia Shtetërore për Shpronësimet.
- 1.4 Këto udhëzime ("Udhëzimet për Ofertuesit") si dhe "Ftesa për Ofertë" i adresohet të gjithë subjekteve juridike ose bashkimeve të tyre, që kanë për qëllim të marrin pjesë në këtë procedurë konkurruese përzgjedhjeje.



- 1.5** Shpenzimet: Ofertuesi Fitues duhet të përballojë shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tij si dhe çdo shpenzim tjetër ashtu siç parashikohet në këto dokumente në përputhje me nenin 25 dhe nenin 29 të ligjit nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar.
- 1.6** Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të ndërprerë përfundimisht këtë Procedurë konkurruese përzgjedhëse. Ofertuesi nuk ka asnjë të drejtë për të kërkuar ndonjë kompensim për kostot ose humbjet.

## **2. DOKUMENTET E PROCEDURËS KONKURUESE**

### **2.1 Përmbajtja**

#### **2.1.1 Lloji i projektit dhe kërkesat teknike, procedura e konkurimit, kushtet e kontratës dhe kërkesat ligjore dhe ekonomike financiare përcaktohen në dokumentat e procedurës konkurruese të cilat përmbajnë :**

### **SHTOJCAT**

Shtojca 1: Formulari i Ofertës

Shtojca 2: Formulari i Ftesës për Ofertë i Procedurës së Kufizuar ose Negociimi me Shpallje (jo e aplikueshme)

(Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Formulari i Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklarate mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike nga operatori ekonomik

Shtojca 6 Deklarata për konfliktin e interesit

Shtojca 7 Formular i vlerësimit për realizimin e punimeve

Shtojca 8: Deklarata e disponueshmerise se makinerive

Shtojca 9 Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/pjesëmarrjes

Shtojca 10: Deklarate mbi gjendjen gjyqësore

Shtojca 11: Kriteret e vlerësimit

Shtojca 12: Vetdeklarim për ofertuesit e huaj

Shtojca 13: Projekt – zbatimi dhe specifikimet teknike

Shtojca 14: Preventivat

Shtojca 15: Formulari për Njoftimin S’kualifikimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 17: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës  
Shtojca 18: Kushtet e Veçanta të Kontratës  
Shtojca 19: Formulari i Sigurimit të Kontratës  
Shtojca 20: Njoftim i Nënshkrimit të Kontratës  
Shtojca 21. Formulari i Ankesës ne Autoritetin Kontraktor  
Shtojca 22: Formulari i Prokurës

**2.1.2** Çdo ofertues duhet të marrë në konsideratë udhëzimet, kriteret, kushtet, specifikimet, afatet dhe të gjithë informacionin në dokumentat e procedurës konkurruese. Në rast se ofertuesi:

- i) nuk plotëson të gjithë dokumentacionin dhe informacionin në dokumentat e procedurës konkurruese; ose
- ii) paraqet një oferte e cila nuk është në përputhje me kushtet dhe kërkesat e dokumentave të procedurës konkurruese.

Autoriteti kontraktues do të përcaktojë se oferta nuk është në përputhje me kërkesat e dokumentave të procedurës konkurruese dhe do të refuzojë ofertën.

## **2.2 Sqarime mbi Dokumentet Standarte të Procedurës Konkurruese:**

**2.2.1** Ofertuesi i cili kërkon sqarime apo ndryshime të dokumentave të procedurës konkurruese, duhet të paraqesë kërkesën e tij nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik.

Të gjitha përgjigjet së bashku me sqarimet përkatëse, duhet tu bëhen të njohura tegjithë të interesuarve.

## **2.3 Ndryshimet në dokumentet e procedurës konkurruese:**

**2.3.1** Në çdo kohë para afatit të dorëzimit të ofertave, Autoriteti Kontraktues në cdo rast që bën ndryshime në dokumentat e procedurës duhet të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave sipas ligjit. AK mund për çdo arsye, me nismën e tij ose në përgjigje të kërkesave për ndryshime nga një ofertues, të ndryshojë dokumentat e procedurës ofertuese.

**2.3.2** Të gjitha ndryshimet e kryera nga Autoriteti Kontraktues do të publikohen në faqen e internetit të APP. Dokumentet e ndryshuara do të konsiderohen si dokumentet e procedurës konkurruese për këtë procedurë përzgjedhëse konkurruese.

**2.3.3** Në mënyrë që ofertuesit të kenë kohë të mjaftueshme për të bërë ndryshimet përkatëse në ofertën e tyre, Autoriteti Kontraktues mund, që me nismën e tij të shtyjë afatin e dorëzimit të ofertave. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues sipas ligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” do të publikojë afatin e ri për dorëzimin e ofertave në faqen e internetit të APP.

## **3. OFERTA: PËRGATITJA**

### **3.1. Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm:**

- a) Formulari i Ofertës, plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojca 1 e DPK/PPP.
- b) Formulari i Sigurimit të ofertës plotësuar në përputhje me modelin e bashkangjitur si Shtojcat 3 e DPK /PPP.
- c) Dokumentat që lidhen me objektin e koncesionit/partneritetit publik privat në përputhje me kërkesat e parashtruara ne Shtojcën 9 e DPK /PPP

Një Operator Ekonomik duhet të paraqesë vetëm një ofertë.

Çdo e dhënë e rreme do të përbëjë për Autoritetin Kontraktues shkakun ligjor për skualifikimin në çdo kohë të Ofertuesit. Nëse kjo zbulohet ose njoftohet pas lidhjes së kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i japë fund marrëdhënieve të kontratës në mënyrë të njëanshme dhe të marrë dëmshpërblim për humbjet aktuale. Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, dhënia e informacioneve të rreme, përpilimi i dokumenteve të rreme apo të falsifikuara si dhe çdo deklaratë apo ndonjë e dhënë tjetër, që nuk pasqyron të vërtetën, konsiderohet vepër penale.

Ofertuesi duhet të përdorë vetëm Dokumentat e Procedurës Konkurruese, pa i bërë asnjë ndryshim përmbajtjes së tyre.

### **3.2 Sigurimi i Ofertës:**

- 321** Si pjesë e ofertës së tij teknike ofertuesi duhet të paraqesë Sigurimin e Ofertës, sipas Formularit të Sigurimit të Ofertës (paraqitur në Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës), në vlerën 2% të vlerës së Investimit të propozuar nga Ofertuesi.
- 322** Sigurimi i Ofertës është i detyrueshëm të paraqitet në formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë ose një shoqëri sigurimi e licencuar nga shteti për të ushtruar këtë aktivitet. Ofertuesi duhet të garantojë, që Sigurimi i Ofertës të jetë i vlefshëm për një periudhë 30 ditore pas përfundimit të vlefshmërisë së ofertës, e cila është 150 dite. Pra oferta duhet të sigurohet për 180 ditë nga data e përfundimit të afatit të dorëzimit të saj. Për arsye të motivuara Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës, në rast se rrethana të caktuara ndikojnë në shtyrjen e afatit të vlerësimit të ofertës përkatëse ose në dorëzimin e Sigurimit të Kontratës ose në çdo rast tjetër që ndikon në shtyrjen e ndonjë afati të detyrueshëm. Mos shtyrja e periudhës së vlefshmërisë së Sigurimit të Ofertës përbën shkak për skualifikimin e Ofertuesit.
- 323** Sigurimi i Ofertës duhet të dorëzohet bashkë me ofertën para skadimit të afatit kohor për dorëzimin e ofertave. Çdo oferte e pashoqëruar me Sigurimin e Ofertës do të refuzohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Sigurimi i Ofertës duhet të paraqitet në emër të: i) shoqërisë, në rast se Ofertuesi është një shoqëri e vetme; ose ii) në emër të shoqërisë kryesuese në rast se Ofertuesi është një bashkim i përkohshëm i shoqërive.
- 324** Me kërkesë të Ofertuesit jo fitues, Autoriteti Kontraktues do t'i kthejë atij Sigurimin e Ofertës sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës apo çdo zgjatje të afatit të saj.
- 325** Sigurimi i ofertës të Ofertuesit Fitues do të kthehet atij pas dorëzimit të Sigurimit të Kontratës pranë Autoritetit Kontraktues.
- 326** Sigurimi i ofertës mund të mbahet nga Autoriteti Kontraktues në rastet kur Ofertuesi:
- i) tërheq ofertën e tij gjatë procedurës konkurruese pa mbaruar afati i vlefshmërisë së ofertës;
  - ii) nuk paraqet Sigurimin e Kontratës (në rast se shpallet fitues);
  - iii) nuk nënshkruan kontratën koncesionare (në rast se shpallet fitues) brenda afateve kohore të specifikuar në Formularin e Njoftimit të Fituesit (Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Fituesit);

- iv) ka deklaruar të dhëna të rreme në ofertën e tij;
- v) ne rast se shpallet fitues refuzon pagesën e shpenzimeve sipas pikës 1.4 me sipër.

**3.3 Prokura:** Çdo Ofertues (ose anëtar i Bashkimit të Përkohshëm, kur Ofertuesi është i tillë) duhet të dorëzojë një prokurë noteriale, në formën e përcaktuar në Shtojcën 21 që tregon se personi (personat) që kanë nënshkruar Ofertën kanë të drejtën e nënshkrimit të saj.

**3.4 Periudha e Vlefshmërisë së Ofertës:** Ofertat duhet të jenë të vlefshme për 150 ditë duke filluar nga momenti i përfundimit të “afatit kohor për dorëzimin e ofertave”. Një oferte me një vlefshmëri më të shkurtër se afati i përcaktuar do të refuzohet nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave si e papranueshme.

Në mënyrë përjashtimore, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga Ofertuesi zgjatjen e Periudhës së Vlefshmërisë së Ofertës. Kërkesa e Autoritetit Kontraktues dhe përgjigja e Ofertuesit duhet të jepen në formë të shkruar. Në rast të zgjatjes së Afatit të Vlefshmërisë së Ofertës, edhe afati i Sigurimit të ofertës do të zgjatet në përputhje me pikën 3.2.2.

### **3.5 Formati dhe nënshkrimi i Ofertës**

**351** Çdo ofertues duhet të përgatisë dhe dorëzojë ofertën në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik (APP). Informacione të detajuara lidhur me ngarkimin e ofertës gjenden në manualin e përdorimit, i cili është publikuar në adresën <https://www.app.gov.al>.

**352** Ofertuesi, i cili do të shpallet fitues i konkurrimit, do të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues ofertën origjinale. Oferta origjinale duhet të jetë e shtypur/printuar ose e shkruar me bojë, e cila nuk fshihet. Personi ose personat me të drejtë nënshkrimi (te autorizuar me prokurën e dorëzuar si pjesë të Ofertës Teknike, në përputhje me pikën 3.3) duhet të nënshkruajnë Ofertën duke:

- i) Nënshkruar origjinalin e ofertës; dhe
- ii) Shënuar inicialet në secilën faqe të origjinalit të dokumentave që shoqërojnë ofertën ekonomike.

**353** Oferta nuk duhet të ketë ndryshime, fshirje apo shtesa, me përjashtim të rastit kur korrigjimet nënshkruhen nga personi apo personat me të drejtë nënshkrimi të ofertës. Oferta origjinale duhet të jetë identike me ofertën e ngarkuar në faqen e internetit të APP.

## **4. DOREZIMI I OFERTES ORIGJINALE**

### **4.1 Formati dhe nënshkrimi i ofertës**

**4.1.1** Në zbatim të VKM Nr.130, datë 12.03.2014 "Për Kryerjen në Mënyrë Elektronike të Procedurave Konkurruese të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat" dhe VKM Nr. 575 datë 10.7.2013, "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve/partneritetit publik privat", oferta do të dorëzohet në format elektronik në përputhje me udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik. Një informacion me të qartë të kësaj procedure do të gjeni në faqen zyrtare [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).

**4.1.2** Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj çdo Ofertuesi ndaj çdo pretendimi apo ankese mbi paqartësi në mënyrën e dorëzimit të Ofertës me përjashtim të rastit kur një ofertë nuk sigurohet në mënyrën e duhur për shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur nga ana e Autoritetit Kontraktor.

**4.1.3** Në çdo rast, Ofertuesit duhet të dorëzojnë në formë elektronike të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm si dhe të nevojshëm për prezantimin e ofertës së tyre.

**4.1.4** Ofertuesi i shpallur fitues duhet të dorëzojë ofertën origjinale pranë Autoritetit Kontraktues. Oferta origjinale duhet të vendoset në një zarf/kuti, të jetë e mbyllur dhe e vulosur. Mbi zarf/kuti duhet të jetë pasqyruar emri dhe adresa e ofertuesit si dhe shënimi: Ofertë për projektin “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e aeroportit ndërkombëtar të Sarandës (SIA)”.  
Oferta origjinale duhet të dorëzohet në adresën e mëposhtme:

|              |  |
|--------------|--|
| Drejtuar:    | Ministria e Infrastrukturaes dhe Energjisë |
| Në vemëndje: | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave         |
| Adresa:      | Rruga "Abdi Toptani", Nr.1 Tirane          |

## **4.2 Afati për dorëzimin e Ofertave**

**4.2.1** Ofertat duhet të dorëzohen në faqen e internetit të APP brenda datës 26/11/2021, ora 12:00 CET. Ofertuesi i shpallur fitues do të njoftohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues për afatin e dorëzimit të ofertës origjinale.

## **5. HAPJA DHE VLERESIMI I OFERTAVE**

### **5.1 Hapia e Ofertave**

**5.1.1** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bën identifikimin e ofertuesve dhe hapjen e ofertave të dorëzuara në faqen e internetit të APP pas mbarimit të afatit për dorëzimin e ofertave.

### **5.2 Vlerësimi i Ofertave**

**5.2.1** Pas hapjes së ofertës Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do t'a shqyrtojë atë për të përcaktuar nëse oferta është e pranueshme, nëse dokumentacioni i kërkuar është dorëzuar, nëse dokumentacioni i kërkuar për tu nënshkruar nga ofertuesi është nënshkruar rregullisht, dhe nëse Oferta është e rregullt.

**5.2.2** Vlerësimi i Autoritetit kontraktues do të bazohet në të dhënat dhe vete përmbajtjen e Ofertës dhe nëse është e nevojshme, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të kërkojë sqarime nga Ofertuesit, të cilat nuk përbejnë një ndryshim të thelbit të Ofertës. Sqarimet duhet të jenë vetëm me shkrim ose/dhe të reflektuara në procesverbalin përkatës. Gjithashtu në raste të veçanta Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e tij për të përfshirë edhe eksperte të ndryshëm të cilët mund të ndihmojnë në trajtimin e atyre çështjeve për të cilat Komisioni i Vlerësimit të Ofertave has vështirësi.

### **5.2.3. Oferta do të konsiderohet e pavlefshme nëse;**

- i) ofertuesi nuk ka dorëzuar Sigurimin e Ofertës;
- ii) oferta përmban të dhëna të rreme;
- iii) nuk ka plotësuar një ose të gjitha kërkesat e ftesës për procedurën konkurruese.

**5.24** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentat e procedurës përzgjedhëse, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

**5.25** Nëse më shumë se një ofertë financiare ka të njëjtën vlerë ose ka pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve.

**5.26** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili duhet të njoftohet publikisht dhe t'i komunikohet Ofertuesve. Pas njoftimit të klasifikimit përfundimtar, çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është në kundërshtim me parashikimet e Ligjit Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" i ndryshuar dhe VKM nr. 575, datë 10.7.2013 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve/partneritetit publik privat", i ndryshuar, duke përdorur formularin e Ankimit të Procedurës Konkurruese, të përcaktuar në shtojcën 20.

**5.27** Me mbarimin e procedurës ankimore Komisioni i Vlerësimit të Ofertave përgatit raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave dhe i propozon Kryetarit të Autoritetit Kontraktues, rezultatet e arritura për secilin prej ofertuesve.

### **5.3 Pavlefshmëria dhe Mos-suksesi i Procedurës Konkurruese;**

Procedura konkurruese quhet e pasuksesshme kur:

- i) asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përmbush kërkesat e ftesës për procedurë konkurruese;
- ii) Autoriteti kontraktues, për mungesë të leverdisë ekonomike të ofertave ose të vetë projektit, shpall mbylljen e procedurës konkurruese;
- iii) Ose kur nuk ka pjesëmarrës në gare.

### **5.4 Veprimet e kundraligjshme**

Në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, dhe etikën në administratën publike, Autoriteti Kontraktues e refuzon një ofertë, nëse Ofertuesi që e ka paraqitur atë:

- i) i ka dhënë ose përgatitet t'i japë një punonjësi aktual ose të mëparshëm të Autoritetit Kontraktues një dhuratë në para ose jo, si një përpjekje për të ndikuar një veprim ose vendim, ose rrjedhën e procedurës së konkurrimit; dhe/ose
- ii) është në kushtet e konfliktit të interesit në këtë procedurë, si p.sh. – një ofertues është i lidhur me një person fizik ose juridik, që është ngarkuar nga Autoriteti Kontraktues të japë shërbime këshilluese gjatë përgatitjes së projekteve, specifikimeve ose dokumentave të tjerë lidhur me procedurën konkurruese, apo ka lidhje me anëtarë të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

iii) Ka dorëzuar dokumenta/informacione të rreme, që lidhen me kërkesat e paraqitura ne Dokumentet Standarte te Procedurës Konkurruese.

Autoriteti Kontraktues e informon me shkrim ofertuesin dhe Agjencinë e Prokurimit Publik për refuzimin e ofertës, si dhe për arsyet e këtij refuzimi, dhe bën shënimin përkatës në raportin për procedurën e konkurrimit.

## **5.5 Përcaktimi i Ofertuesit Fitues dhe Nënshkrimi i Kontratës**

**5.5.1** Pas përfundimit të afatit të ankimimit, të përcaktuar në pikën 5.2.6, Autoriteti Kontraktues informon Ofertuesin, oferta e të cilit është përzgjedhur si më e mira, përmes dërgimit të Njoftimit të Fituesit, siç parashikohet në Formularin e Njoftimit të Fituesit. Një kopje e zgjeruar e këtij njoftimi publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike. Gjatë nënshkrimit, Autoriteti Kontraktues i kërkon Ofertuesit Fitues paraqitjen e Sigurimit të Kontratës, në masën 5% të vlerës së projektit të propozuar.

Formulari i Sigurimit të Kontratës, duhet të nënshkruhet dhe të dorëzohet sipas pikës 5.5.3. Sigurimi i Kontratës mund të dorëzohet në formën e një i) garancie bankare e pakushtëzuar ose ii) nëpërmjet një police sigurimi.

**5.5.2** Autoriteti Kontraktues dhe Ofertuesi Fitues do të negociojnë në mirëbesim kushtet dhe afatet përfundimtare të Kontratës Koncesionare/Partneritetit Publik Privat, duke pasur parasysh se Ofertuesi Fitues do të kërkojë të nënshkruajë Kontratën Koncesionare sipas Kushteve të Veçanta dhe të Përgjithshme të Kontratës të nënshkruar nga ai në çdo faqe dhe të dorëzuar si pjesë e Ofertës Teknike, të ndryshuara (nëse është e aplikueshme) gjatë procesit të negocimit të Kontratës Koncesionare/ Partneritetit Publik Privat. Ofertuesi i shpallur Fitues do të krijojë Subjektin për Qëllime të Veçanta (SPV), të rregulluar sipas legjislacionit në fuqi, si një shoqëri me seli në Republikën e Shqipërisë me shënimin para emrit “Shoqëri koncesionare” dhe me objekt “Objektin e kontratës së koncesionit”, me të cilin Autoriteti Kontraktues do të nënshkruajë Kontratën e Koncesionit, me personin e autorizuar të shoqërisë në fjalë.

**5.5.3** Nëse brenda një afati kohor 60 ditor nga data e Njoftimit të Fituesit dhe afatit të përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave behet e qarte se, nëse Ofertuesi Fitues (për arsye të pajustificuara) nuk do të dorëzojë Sigurimin e Kontratës dhe/ose nuk do të nënshkruajë Kushtet e Veçanta dhe të Përgjithshme të Kontratës, Autoriteti Kontraktues do t’i mbaje Ofertuesit Fitues, Sigurimin e Ofertës dhe do të ftojë Ofertuesite tjerë, sipas radhës në klasifikimin përfundimtar, deri sa të marre Sigurimin e Kontratës dhe Kushtet e Përgjithshme dhe të Veçanta të nënshkruara në çdo faqe nga Ofertuesit sipas radhës, apo të refuzojë të gjitha Ofertat e mbetura.

**5.5.4** Autoriteti Kontraktues do të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Publike emrin e Koncesionarit dhe termat kryesore të Kontratës Koncesionare, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

## Shtojca 1

[Shtojce per tu paraqitur nga Operatori Ekonomik]

### FORMULARI I OFERTËS

**Drejtuar:** Ministrisë se Infrastruktures dhe Energjisë  
Adresa: Rruga □Abdi Toptani□Nr.1 ,  
Tirane

**Lënda :** Oferta e shoqërisë/e bashkimit te përkohshëm te shoqërive (*vendosni emrin e Ofertuesit*), per procedurën konkurruese "Dhënie me koncesion/PPP “Për projektimin,ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Sarandës.

**Duke i'u referuar procedures se lartpermendur, ne, te nenshkruarit, deklarojme se:**

1. Cmimi total i ofertes sone eshte [monedha dhe vlere e ofertes]; PATVSH
2. Cmimi total i ofertes sone eshte [monedha dhe vlere e ofertes]; METVSH

**Date** ..... \_\_\_\_\_

Forma e paraqitjes se ofertës përcaktohet si me poshtë:

| Nr.      | Kriteret   | Oferta/Referenca |
|----------|--|------------------|
| <b>1</b> | Përmbledhja e shkurtër dhe arsyetimi strategjik i projektit duke përfshirë:  |                  |
|          | a Plani i zonimit te tokes sipas faciliteteve te aeroportit  |                  |
|          | b Zgjidhje me Vlerë të Shtuar  |                  |
|          | c Përgjegjësia Sociale:  |                  |
| <b>2</b> | Përvojë ne Projekte Ndërtimi dhe/ose Renovimi i tëpaktën 1 (një) aeroporti ku rinovimi konsiston në terminalin e pasagjereve;pista dhe vendqendrimi (Kategoria 3C ose me lart), gjatë 10 (dhjetë)viteve të fundit, me kapacitet 1 (një) milion pasagjerë ose më shumë. |                  |
| <b>3</b> | Përvoja e Operimit dhe Mirëmbajtjes (O&M)  |                  |
| <b>4</b> | Përvoja mbi përfitimn e financimeve  |                  |
| <b>5</b> | Rritja e Nr. Pasagjerëve   |                  |
| <b>6</b> | Tarifë Koncesionare  |                  |
| <b>7</b> | Koha e vënies në operim  |                  |

**Shenim:** Ofertuesi duhet te japë jo me tepër se një te dhënë per çdo kriter, bazuar kjo ne Projektin dhe plan biznesin e paraqitur prej tij.

1. Cmimet duhet te shprehen ne Monedhen \_\_\_\_\_(E kerkuar ne dokumentet e tenderit)



Kujdes ne formulimin e ofertës, s' duhet te ketë forma alternative te paraqitjes se saj

---

Emri, Nenshkrimi dhe vula e Ofertuesit

## Shtojca 2

### FTESA PER OFERTE

Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë fton për të paraqitur oferta për kryerjen e Puneve të mëposhtme:

#### Vendi i kryerjes së kontratës së punës

Aeroporti i Sarandës i cili ndodhet në zonën e Finiqit, të Sarandës.

Vendndodhja e aeroportit te propozuar ne Sarande shtrihet ne fushat e Vurgut, prane liqenit te Butrintit ne te ashtuquajturen ish keneta e Bufit. Nga bonifikimi i kesaj kenete jane perftuar toka bujqesore. Ndodhet rreth 6 km larg nga Qyteti i Sarandes, prane rruges nacionale, ne lartesi 20 m mbi nivelin e detit. Ne perimetrin e zones se projektit te distancuar prej saj ndodhen fshatrat, Cuke, Ç aush, Aliko, Neohor, Dritas, Vurgu i ri, Lekursi. Nga ana perendimore zona e projektit kufizohet me kodrat ku shtrihen fshati Lekursi me kalane e tij dhe pertej kodrave shtrihet qyteti i Sarandes. Nga ana jugore kufizohet me liqenin e Butrintit. Nga ana lindore aeroporti i propozuar kufizohet me fshatrat Aliko, Dritas, Neohor. Nga ana veriore kufizohet me fshatin Vrion dhe Lumin Bistrica.

Afati i ekzekutimit të kontratës (sipas ofertes fituese te vleresuar nga KVO)

Oferta duhet të paraqitet

Per llogari te Autoriteti Kontraktues: Ministria e Infrastruktures dhe Energjise

Brenda dhe jo me vone se ora 12:00 CET, te datës 26/11/2021

**Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të eeb-it të APP-së, [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al).**

### Shtojca 3

[Letër me logon e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

[ Shtojce per tu paraqitur nga operatori ekonomik]

#### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emer të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

Procedura e koncesionit/partneritetit publik privat [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [ objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës / kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka terhequr ose ka ndryshuar oferten, pas afatit perfundimtar per paraqitjen e ofertave ose para afatit perfundimtar, nese eshte percaktuar keshtu ne dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nenshkrimin e kontrates se koncesionit/partneritetit publik privat kur autoriteti kontraktor e kerkon nje gje te tille;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur Sigurimin e Kontrates, ku oferta eshte shpallur fituese ose nuk ka plotesuar ndonje kusht tjeter perpara nenshkrimit te kontrates se percaktuar ne dokumentet e tenderit.;

Ky Sigurim është i vlefshëm [njoftimin e kontratës ose ftesën për tender] ditë nga data e mbarimit të afatit të dorëzimit të ofertave në faqen e internetit të APP-së.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

## Shtojca 4

### LISTA E INFORMACIONIT KONFIDENCIAL

[ *Shtojce per tu plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri faqes dhe pikat e DSK/PPP që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|--|--|--|
|   |  |  |  |
|   |  |  |  |
|   |  |  |  |
|   |  |  |  |
|   |  |  |  |
|   |  |  |  |

## Shtojca 5

[ Shtojce per tu plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATE E PERMBUSHJES SË KËRKESAVE TË DOKUMENTAVE STANDARTE TË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës ne procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat qe do të zhvillohet ne date \_\_\_\_\_nga Autoriteti Kontraktor\_\_\_\_\_me objekt \_\_\_\_\_

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_me cilësinë \_\_\_\_\_te operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Përbushim te gjitha specifikimet teknike, te përcaktuara ne dokumentat e Koncesionit/Partneritetit publik Privat dhe i pranojmë pa rezerva dhe asnjë vërejtje ato. Deklarojmë nen përgjegjësinë tone ligjore se jemi dakord me te gjitha specifikimet teknike te dhëna dhe i plotësojmë ato sipas përcaktimit ne dokumentat e Koncesionit/Partneritetit publik Privat. Ne përbushim të gjitha kërkesat ligjore, financiaro-ekonomike si dhe specifikimetteknike të përcaktuara në dokumentat standarte të procedurës konkurruese, dhe vërtetojmë këtë me certifikata dhe dokumenta, të dorëzuara bashkë me këtë deklaratë.

Oferta jonë është e vlefshme për periudhën e përcaktuar në dokumentat standarte për procedurën konkurruese.

Nuk do të marrim pjesë si ofertues në më shumë se një ofertë për këtë procedurë konkurruese.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin/ dokumentat që i bashkëlidhën kësaj oferte.

Në rast se oferta jonë pranohet në do të bëjmë sigurimin e kontratës, sic parashikohet në dokumentat standarte të procedurës konkurruese.

Në rast se shpallemi fitues të procedurës konkurruese, biem dakord për të nënshkruar Kontratën sipas formularit të kushteve të kontratës.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

## Shtojca 6

[ Shtojce per tu plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### **DEKLARATË** **Mbi konfliktin e interesave**

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e koncesionit/partneritetit publik privat që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësiive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1,2 te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, fëmijë madhorë apo prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es, bashkëjetuesi/ja**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet/partneritetin publik privat”.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

**Vula**



## Shtojca 7

[ Shtojce per tu paraqitur nga Operatori Ekonomik]

### FORMULAR VLERESIMI

( Ky formular do te shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

|   |
|---|
| Autoriteti kontraktor/Investitori   |
| Adresa/Tel.   |
| Emri i Titullarit/Administratorit   |
| <b>VERTETOJ SE:</b>   |
| Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me  |
| Emri i operatorit NIPT/<br>Bashkimit te operatoreve NIPDET/<br>Nënkontraktohet NIPDET   |
| Adresa/t  |
| Objekti i kontratës:  |
| Data e fillimit te kontratës      Data e mbarimit te kontratës<br>Vlera sipas kontratës Vlera erealizuar<br>% e bashkimit te O.E. dhe përshkrimi i punëve te kryera nga secili anëtar<br>Nënkontraktohet.<br>Vlerësimi      (shprehur me fjale)<br><br>E përmbushur<br>E papërmbushur |
| <b>Firma</b>  |



**Vula e Autoritetit Kontraktor**

## Shtojca 8

[ Shtojce per tu plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: \_\_\_\_\_

**Deklaroj se zotëron mjetet pajisjet teknike dhe asete te tjera fizike per te realizuar kontratën me objekt: \_\_\_\_\_**

| Ne pronesi     |       |                       |             |          |
|----------------|-------|-----------------------|-------------|----------|
| Lloji i Mjetit | Targa | Nr. Lejes qarkullimit | Nr. Shasise | Te tjera |
| 1              |       |                       |             |          |
| 2              |       |                       |             |          |

Dhe

| Me qera        |                |                                 |                       |                                 |  |
|----------------|----------------|---------------------------------|-----------------------|---------------------------------|--|
| Lloji i Mjetit | Targa e mjetit | Nr. Lejes qarkullimit Te mjetit | Nr. Shasise Se mjetit | Nr. Kont se qerasese (noterise) | Afati i kontrates qerasese(Data e fillimit dhe mbarimit) |
| 1              |                |                                 |                       |                                 |  |
| 2              |                |                                 |                       |                                 |  |

shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë ne këtë tabelë.

### PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

**Emri:**

**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**

**Faks:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi  
Vula**

## Shtojca 9

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
  - a) nuk është në proces falimentimi,
  - b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Ligjin 162/2020 “Per Prokurimin Publik”,
  - c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional.

Kërkesat si më sipër, plotësohen me dorëzimin e Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat e Subjektit, Ekstraktit mbi Historikun e Subjektit, të lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe vetëdeklarimin e subjektit, sipas Shtojcës Nr. 10 “Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore.

2. Një dokument që vërteton se (subjekti juaj):
  - a) ka plotësuar detyrimet fiskale,
  - b) ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kritere (pikat 1,2,) duhet të vërtetohen përmes dokumenteve të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertës.

3. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor, për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Kandidati/Ofertuesi i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendur nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentet e lartpërmendur.

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas se cilës bashkimi i operatoreve ekonomik është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimi i ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;

c. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;

ç. Përshkrimi i Ofertës i plotësuar dhe nënshkruar në mënyrë të duhur, sipas Shtojcës 1;

d. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 7 (sipas rastit);

2. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar, ofertuesi duhet të paraqesë:

## 2.1. Kapaciteti Ligjor i operatorëve ekonomikë,

1. Regjistrimi si person juridik. Ekstrakt i regjistrit tregtar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
2. NIPT-i;
3. Dokument qe vërteton se kapitalet/asetet e subjektit tuaj nuk janë ne duart e përmbaruesit gjyqësor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, lëshuar nga Zyra e Përmbarimit ne qytetin ku keni selinë tuaj qendrore;
4. Dokument qe vërteton se subjekti juaj i ka plotësuar detyrimet fiskale, lëshuar nga Administrata Tatimore;
5. Dokument qe vërteton se subjekti juaj i ka paguar te gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Administrata Tatimore;
6. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. Kjo kerkese eshte vetem per Operatoret Ekonomik Shqiptare.

Kriteret e mësipërme përmbushen vetëm nëse dokumentet e paraqitura janë origjinale ose fotokopje te noterizuara.

Shoqëritë ofertuese duhet te jene te regjistruara ne regjistrat përkatës profesionale ose tregtare te shtetit ne te cilin ato janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor. Për këtë ofertuesit duhet te dorëzojnë Ekstraktin mbi historikun e subjektit te lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Ofertuesi i huaj (shoqëri e regjistruar jashtë territorit te Shqipërisë) duhet te vërtetojë se i plotëson te gjitha kërkesat e renditura me sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendur ne pikat përkatëse nuk lëshohen ne shtetin e origjinës te ofertuesit, atëherë ato do te pranohen ne formën e deklaratës me shkrim, nen përgjegjësinë e ofertuesit (sipas formës se paraqitur ne Shtojcën 11). Lidhur me deklarimin e mos lëshimit te këtyre vërtetimeve nga institucione te shtetit te origjinës, ofertuesit duhet te paraqesin vërtetim nga Dhoma e Tregtisë se vendit te origjinës - duke evidentuar faktin se ndonjë apo te gjitha vërtetimet e kërkuara ne këtë Shtojce nuk lëshohen nga ndonjë institucion publik përgjegjës. Sipas rastit, Autoriteti Kontraktues do te investigoje nëse këto vërtetime lëshohen apo jo nga institucionet përkatëse ne vendin e origjinës, dhe ne rast se konstaton zyrtarisht se ne shtetin e origjinës ekziston një institucion i cili mund te lëshoj një vërtetim te tille, te paraqitur nga ofertuesi i huaj ne formën e vetë deklarimit atëherë Komisioni do te quaj te pavlefshëm dokumentin vetë deklarues te paraqitur.

Ne rastet e bashkimit te përkohshëm te shoqërive, kërkesat e Shtojcës 11 janë te detyrueshme për secilin prej anëtareve te këtij bashkimi.

### Legalizimi i dokumentacionit

Dokumentet e siguruar jashtë territorit të Shqipërisë nga subjekte juridike të huaja duhet të jenë të legalizuara në mënyrë që të kenë vlerë ligjore. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëritë që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 TETOR 1961) duhet të përmbajë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

### **Bashkimi i përkohshëm i shoqërive**

Operatorët ekonomikë mund të ofertojnë të vetëm ose të krijojnë grupe operatorësh ekonomikë dhe të ofertojnë si një kandidat i vetëm.

Oferta mund të paraqitet nga një grup operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e punës që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

Përpara dorëzimit të ofertës, bashkimi i përkohshëm duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së secilit anëtar dhe elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi të përkohshëm. Vullneti për të hyrë në marrëveshje të bashkimit të përkohshëm të shoqërive duhet të jetë i shprehur qartë me vendim të organit vendimmarrës të të gjitha shoqërive pjesëmarrëse në kontratën e bashkimit të përkohshëm. Për të vërtetuar se cili është organi vendimmarrës në këtë bashkim të përkohshëm shoqëror, duhet të paraqitet statuti aktual i secilës prej shoqërive pjesëmarrëse në këtë bashkim të përkohshëm.

Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit caktojnë, me prokurë, përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në procedurë në emër të Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë.

Operatori ekonomik, pjesëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht dhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet.

Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, i caktuar si përfaqësues i grupit dhe i propozuar nga anëtarët e tjerë jo përfaqësues, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën, përndryshe, autoriteti kontraktor mund të tërhiqet nga kontrata. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, nëse përfaqësuesi i grupit nuk cakton një zëvendësues, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i grupit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.

Shoqëritë shqiptare do të nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Në rastin e shoqërive të huaja do të respektohen normat ligjore për shoqëritë tregtare në shtetin e origjinës.

## **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Ofertuesi duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të konkurrimit dhe mban përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, sic parashikohet apo nënkuptohet në Kushtet e Përgjithshme dhe të veçanta të Kontratës.

Ofertuesi, (*nëse nuk është Bashkim i Perkohshëm i Shoqërive*) – ose shoqëri të lidhura të Ofertuesit – duhet të provojë që ka patur një vlerë neto prej të paktën 41 (dyzet e një) milion EURO apo ekuivalent gjatë 3 (tre) viteve të fundit fiskale.

Nëse Ofertuesi është Bashkim i Perkohshëm i Shoqërive, ai duhet të vërtetojë që vlera e përgjithshme neto e pjesëtarëve të Bashkimit të Perkohshëm të Shoqërive është 41 (dyzet e një) milion EURO gjatë 3 (tre) viteve të fundit fiskale dhe të paktën 30 (tridhjetë) milion EURO për Pjesëtarin Financiar apo Drejtuesin e Bashkimit të Shoqërive. Vlera neto do të llogaritet: Vlera neto = (totali i aktiveve) minus (totalin e detyrimeve).

Dokumentet që provojnë burime të mjaftueshme financiare përfshijnë:

- a. Kopje të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit (2018, 2019 dhe 2020), të paraqitura në administratën tatimore
- b. Raportet e auditimit financiar, (përfshirë opinionin e auditorit), të certifikuara nga një subjekt i jashtëm i licencuar auditimi

## **2.3. Kapaciteti teknik:**

Ofertuesit duhet të plotësojnë kërkesat teknike për kualifikim dhe të dorëzojnë sa më poshtë:

1. Certifikim për një Aeroport nga Autoriteti kompetent për Aviacionin Civil në vendin ku është kryher aktiviteti në përputhje me standardet e kërkuar nga ICAO/EASA brenda 15 viteve të fundit,

Ofertuesit do të deklarojnë dhe parashitrojnë certifikimin e duhur për – të paktën – 1 (një) Aeroport Ndërkombëtar të manaxhuar nga Ofertuesi (*në mënyrë të pavarur, apo si pjesë e një ndërmarrje të përbashkët [Joint Venture], konsorciumi apo marrëveshje tjetër*, apo që një nga Kompanitë e Lidhura me të, e operon në mënyrë aktive [*në tokë e ajër*]): aeroport me jo më pak se 1 (një) milion pasagjerë në vit për të paktën 5 (pesë) vitet e fundit pa ndërprerje;

2. Pjesëmarrje Kontrolluese (*në shoqëri*) / Përfituesi fundor i Kuotave/Aksioneve

Çdo Ofertues duhet të paraqesë strukturën e tij të kapitalit. Kjo strukturë duhet të paraqitet në formë tabelore ku të përcaktohen përqindjet e aksioneve të secilit Aksionar deri tek zotëruesi fundor. Kjo strukturë kapitali duhet të përputhet me përcaktimet për ndarjen e aksioneve ashtu siç përcaktohet në dokumentat ligjore të ofertuesve dhe këtyre dokumenteve standarde.

3. Vendime gjyqësore të formës së prerë apo vendime Arbitrazhi lidhur me Paditë kundër Ofertuesit për mos respektim të Marrëveshjeve Konçesionare.

*Paditë (Vendime gjyqësore të formës së prerë):* Ofertuesit do të paraqesin një listë të shkurtër e të përmbledhur ku përshkruhen veprimet ligjore në 5 (pesë) vitet e fundit ku Ofertuesi apo, nëse është rasti, ndonjë kompani që është pjesë e Konsorciumit të Ofertuesit është dënuar (me vendim të formës së prerë të Gjykatës apo me vendim Arbitrazhi): (i) si debitor në falimentim; (ii) për shkak të performancën së dobët në kudër të realizimit të punimeve në një Kontratë Koncesionare; apo (iii) si i pandehur në çështje kriminale.

#### 4. Përvoja Kontraktore – Ndërtimi

Ofertuesi do të provojë aftësinë dhe kapacitetin e nevojshëm në projekte ndërtimore dhe / ose renovime (përfshirë terminalin; pisten; vend-qendrimin) gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit në të paktën 1 (një) aeroport të Kategorisë 3C ose me lart, me kapacitet te pakten 1 (një) milion pasagjerë ose me shume.

Ofertuesi, ose, nëse Ofertuesi është Bashkim Shoqërisht, një prej Pjesëtarëve duhet në provojë kapacitetin teknik për:

- a. Renovimit të të paktën 1 (një) piste aeroporti, vendqendrimi dhe një terminali gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit dhe/ose
  - b. Ndërtimit të të paktën 1 (një) piste aeroporti, vendqendrimi dhe një terminali gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit
5. Ofertuesi, ose, nëse Ofertuesi është Bashkim Shoqërisht, Operator i Aeroportit, do të provojë përmes renditjes së aeroporteve respektive:
- a. Përvojë në: (a) zhvillim, dizain, inxhinieri, prokurim dhe ndërtim, operim dhe mirëmbajtje dhe (b) menaxhim dhe monitorim të projekteve të ndërtimit të Infrastrukturës të Aeroportit gjatë 5 (pesë) viteve të fundit në të paktën 1 (një) aeroport me kapacitet 1 (një) milion pasagjerë ose me shume.
  - b. Përvojë menaxhuese: mirëmbajtje / riparim i ambienteve dhe prokurim i materialeve të nevojshëm. Ofertuesi do të paraqesë prova të eksperiencës së tij të certifikuar në projekte inxhenerike dhe mirëmbajtje.

Në mënyrë që të përmbushen kërkesat e pikave 4 dhe 5, Ofertuesi duhet të trajtojë fushat e mëposhtme sa i përket kapacitetit operacional dhe menaxhues:

- i. Ekspertiza e Operimit dhe Mirëmbajtjes: Siguroni dokumentacion që dëshmon ekspertizë në menaxhimin aeropotual të natyrës së përmendur më sipër. Në mënyrë të veçantë, Ofertuesi duhet të theksojë eksperiencën në fushat e mëposhtme:

1. Përvojë thelbësore në menaxhimin dhe përmirësimin e të paktën një aeroporti tregtar.
  2. Përvojë thelbësore në menaxhimin, mirëmbajtjen / riparimin e objekteve të aeroportit dhe prokurimin e materialeve përkatëse për mirëmbajtje.
  3. Përvojë në rritjen e numrit të pasagjerëve.
- ii. Parezikshmëria dhe Siguria (*Safety and Security*): Tregoni aftësi për të trajtuar dhe zgjidhur çështje të parrezikshmërisë dhe sigurisë (*Safety and Security*). Në mënyrë të veçantë, Ofertuesi duhet të nxjerrë në pah përvojën dhe kualifikimet në fushat vijuese:
1. Të ketë ngritur, operuar dhe zhvilluar sistemin e menaxhimit të parrezikshmërisë dhe sigurisë (*Safety and Security*) në aeroport.
  2. Përvojë në mbështetjen e reagimit emergjent.
  3. Ekspertizë për menaxhimin mjedisor.
6. Raport me Strukturën bazë të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore” (të ndryshuar), ku është e aplikueshme.
- Ofertuesit të cilët nuk sigurojnë Kapacitetin Teknik të kërkuar në kuadër të këtij Njoftimi siç përmenden, si dhe çdo dokument tjetër në këtë Njoftim, apo nëse dokumenti/tet është / janë në mos përputhje, do të konsiderohen jo të pranueshëm për të vijuar pjesëmarrjen në tender dhe të dhënat e tyre financiare nuk do të vlerësohen.
  - Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.



## Shtojca 10

[ Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik]

### DEKLARATË MBI GJENDJEN GJYQËSORE

E operatorit ekonomik pjesëmarrës ne procedurën e kncesionit qe do të zhvillohet ne date \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktues \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ te operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se:

Υ Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Ligjin 162/2020 “Per Prokurimin Publik”,

Υ Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin profesional,

Data e dorëzimit te deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

## Shtojca 11

### KRITERET E VLERESIMIT

Ofertat do te vlerësohen ne baze te kriterëve te mëposhtme, dhe fitues do te konsiderohet ai ofertues qe ka pike me tepër ne baze te kriterëve te vlerësimit.

Komisioni i Vlerësimit te Ofertave do te vlerësojë Ofertat Teknike dhe Financiare, ne baze te kriterëve te mëposhtme:

#### Metodologjia e vlerësimit

| Nr. | Kriteret  | Pikët maksimale te kriterit | Metodologjia e vleresimit           |
|-----|---|-----------------------------|-------------------------------------|
| 1   | Përmbledhja e shkurtër dhe arsyetimi strategjik i projektit duke përfshirë:   | <b>34</b>                   | -                                   |
|     | a) Plani i zonimit te tokes sipas faciliteteve te aeroportit  | 18                          | -                                   |
|     | b) Zgjidhje me Vlerë të Shtuar  | 10                          | -                                   |
|     | c) Përgjegjësia Sociale:  | 6                           | -                                   |
| 2   | Përvojë ne Projekte Ndërtimi dhe/ose Renovimi i të paktën 1 (një) aeroporti ku rinovimi konsiston në terminalin e pasagjereve;pista dhe vendqendrimi (Kategoria 3C ose me lart), gjatë 10 (dhjetë)viteve të fundit, me kapacitet 1 (një) milion pasagjerë ose më shumë. | <b>10</b>                   | $P_i = \frac{A_i}{A_{max}} * P_k$   |
| 3   | Përvoja e Operimit dhe Mirëmbajtjes (O&M)   | <b>9</b>                    | $P_i = \frac{OM_i}{OM_{max}} * P_k$ |
| 4   | Përvoja mbi përftimin e financimeve   | <b>10</b>                   | $P_i = \frac{L_i}{L_{max}} * P_k$   |
| 5   | Rritja e Nr. Pasagjerëve  | <b>14</b>                   | -                                   |
| 6   | Tarifë Koncesionare   | <b>12</b>                   | $P_i = \frac{F_i}{F_{max}} * P_k$   |
| 7   | Koha e vënies në operim   | <b>11</b>                   | $P_i = \frac{T_{min}}{T_i} * P_k$   |

Ku:

$P_i$  – Piket e ofertuesit

$A_i$  – numri i aeroporteve të ofertuar nga ofertuesi

$A_{max}$  – numri maksimale i ofertuar i aeroporteve

$OM_i$  – numri i aeroporteve te operuara nga ofertuesi

$OM_{max}$  - numri maksimal i ofertuar i aeroporteve të operuara

$L_i$  – shuma e financimeve të kontraktuara për projekt të ofertuesit  
 $L_{max}$  - shuma maksimale e ofertuar e financimeve të kontraktuara për projekt  
 $F_i$  – tarifa e koncesionit e ofertuar  
 $F_{max}$  – tarifa e koncesionit më e lartë e ofertuar  
 $T_i$  – koha e vënies në operim e ofertuesit  
 $T_{min}$  – koha minimale e vënies në operim e ofertuar

*Kriteret e paraqitura në Oferte përbejnë kushte të panegociueshem të Kontratës Koncesionare dhe nuk mund të ndryshohen në asnjë rast.*

### **Shpjegime për kriteret e vlerësimit të ofertuesve dhe metodologjinë e vlerësimit gjatë procedurës konkurruese:**

- 1 Përmbledhja e shkurtër dhe arsyetimi strategjik i projektit duke përfshirë:
  - a Plani i zonimit të tokës sipas faciliteteve të aeroportit
  - b Zgjidhje me Vlerë të Shtuar
  - c Përgjegjësia Sociale:

Ky seksion do të vlerësojë përshkrimin e ekonomikisht, zhvillimit të biznesit dhe zhvillimeve arkitekturore.

#### a) Plani i zonimit të tokës sipas faciliteteve të aeroportit

Ky seksion do të vlerësojë – mbi bazën e propozimi të ofertuesit mënyrën sesi ky i fundit do të zhvillojë aeroportin në mënyrë sa më efikente të përdorimit të tokës – funksionalitet më të mirë të terminalit dhe të shërbimeve të aviacionit, shtrirjen operacionale dhe dizajnin arkitektonik si dhe rezultatet ekonomike dhe mjedisore. Do të vlerësohet gjithashtu përvolja në ndërtimin e instalimeve të furnizimit të avionëve me karburant.

#### b) Zgjidhje me Vlerë të Shtuar

Ky seksion do të vlerësojë mundësitë apo zgjidhjet alternative që mund të shtojnë vlerën e projektit në terma ekonomik / teknologjik / operacional / dhe efikasiteti; si dhe ide dhe informacion mbi aftësinë për të rritur të ardhurat dhe trafikun.

Si qëllim i zgjeruar i Tenderit, Ofertuesit mund të rendisin opsione dhe propozime që synojnë sugjerimin e përmirësimeve të mëtejshme lidhur me marketingun dhe zhvillimin e infrastrukturës.

#### c) Përgjegjësia Sociale

Ky seksion do të vlerësojë mundësitë e ndryshme industriale të cilat udhëheqin drejt mundësive për përmirësimin e niveleve të punësimit dhe/ose të cilat prodhojnë impakt social domethënës dhe/ose mundësi për kualifikime aeronautike.

Ofertuesit me qasjen me te mire me kërkesat ne kete kriter do te vlerësohen me piket maskimale te kriterit

2 Përvojë në Projekte Ndërtimi dhe/ose Renovimi (te terminalit; pistes dhe vendqendrimit) i të paktën 1 (një) aeroporti (Kategoria 3C ose me lart), gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit, me kapacitet 1 (një) milion pasagjerë ose më shumë

Ofertuesi i cili do të provojë aftësinë dhe kapacitetin e nevojshëm në projekte ndërtimore dhe / ose renovime (terminal; piste dhe vend-qendrim) gjatë 10 (dhjetë) viteve të fundit ne me shume aeroporte të Kategorisë 3C ose me larte, me te te pakten 1 (një) milion pasagjerë ose me shume, do te marre piket maksimale te këtij kriteri. Ndersa ofertuesit e tjerë do te marrin piket ne baze te metodologjisë se përcaktuar.

3 Përvoja e Operimit dhe Mirëmbajtjes (O&M)

Ofertuesi, ose, nëse Ofertuesi është Bashkim Shoqerish, Operator i Aeroportit, do të provojë përmes renditjes së aeroporteve respektive:

*Përvojë në:* (a) zhvillim, dizain, inxhinieri, prokurim dhe ndërtim, operim dhe mirëmbajtje dhe (b) menaxhim dhe monitorim të projekteve të ndërtimit të Infrastrukturës të Aeroportit gjatë 5 (pesë) viteve të fundit në të paktën 1 (një) aeroport me kapacitet 1 (një) milion pasagjerë ose me shume pasagjere.

*Përvojë menaxhuese:* mirëmbajtje / riparim i ambienteve dhe prokurim i materialeve të nevojshëm. Ofertuesi do të paraqesë prova të eksperiencës së tij të certifikuar në projekte inxhenerike dhe mirëmbajtje.

Ofertuesi i cili paraqet numrin me te madh te operimit dhe mirëmbajtjes se aeroporteve do te vlerësohet me piket maksimale te kriterit. Ndersa ofertuesit e tjerë do te marrin piket ne baze te metodologjisë se përcaktuar.

4 Përvoja mbi përfitim të financimeve

Ofertuesi, apo, nëse Ofertuesi është Konsorcium, Drejtuesi i Konsorciumit apo Pjesëtari Financiar do të provojnë aftësinë për të financuar Projektin përmes investimeve të kapitalit neto dhe/ose debi – financimi për Projektin, duke përfshirë financimin e të paktën (1) një projekti paraprak te barabarte ose mbi 34 320 000 (tridhjetë e katër milion e treqind e njëzet mijë) EURO në 5 (pesë) vitet e kaluara.

Ofertuesi i cili paraqet vlerën me te larte te përfituar te financimit do te vlerësohet me piket maksimale. Ndersa ofertuesit e tjerë do te marrin piket ne baze te metodologjisë se përcaktuar.

## 5 Rritja e Nr. Pasagjerëve

Ofertuesi duhet të ofrojë prova specifike që dëshmojnë për aftësimin e provuar dhe rezultatet përkatëse për rritjen e numrit të pasagjerëve përmes zhvillimit të rrugëve ajrore dhe marketingut, gjatë 3 (tre) viteve të fundit në 1 ose me shume aeroporte të administruar nga Ofertuesi.

Ofertuesit do të detajojnë eksperiencën e tyre në operim, menaxhim dhe mirëmbajtje të një ose me shume aeroportesh (me kompetenca të qenësishme për trafikun ajror) në pronësi apo me qira nga i njëjti entitet, i lidhur me kontratë, qoftë në formën e një kontrate menaxhimi / O & M, kontrate qiraje apo një marrëveshje koncesioni afat-gjatë, për 3 (tre) vjet rresht në 10 (dhjetë) viteve të fundit.

Ofertuesi me rezultatet me të mira për rritjen e numrit të pasagjerëve, përvojën e rrjetit dhe nivelin me te ulet te tarifave te shërbimit te propozuara do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit.

## 6 Tarifë Koncesionare

Është kompensimi monetar per koncesionin që koncesionari i paguan Autoritetit Kontraktues për përdorimin e Aeroportit te Sarandes. Ajo do të filloje të paguhet që nga momenti i vënies nëshfrytezim të aeroportit. Vlera e saj shprehet me përqindje të të ardhurave vjetore që koncesionari do të krijoj dhe i jep Autoritetit Kontraktues.

Tarifa koncesionare minimale do të jetë 2 % dhe kjo shume eshte kusht i panegociushem i kontrates.

Do te vleresohet me piket maksimale ofertuesi i cili propozon perqindjen me te larte te tarifes koncesionare. Ndersa ofertuesit e tjerë do te marrin piket ne baze te metodologjisë se përcaktuar.

## 7 Koha e vënies në operim

Është kriteri i cili vlerëson ofertuesit në lidhje me afatin në te cilin do të përfundojë ndertimi i aeroportit dhe vënia ne operim te tij.

Ofertuesi me kohën më të shkurtër të arsyeshme të ndërtimit te aeroportit (nga momenti i marrjes se te gjitha lejeve dhe licencave te nevojshme per fillimin e punimeve) dhe vënia ne operim te tij do të vlerësohet me pikët maksimale të kriterit. Ndersa ofertuesit e tjerë do te marrin piket ne baze te metodologjisë se përcaktuar.

## **Shtojca 12**

*[Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik i Huaj]*

### **VETEDEKLARIM PËR OFERTUESIT E HUAJ**

- **Per pjesëmarrjen ne procedurën per marrjen me koncesion/PPP “Për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Sarandes (SIA) nga Koncesionari te AK”**

Per: Ministrinë e Infrastruktures dhe Energjisë

**[Date]**

*[Emri i Ofertuesit /Anetari Kryesues i Bashkimit te Perkohshem]* deklaroj dhe garantoj qe, ne daten e kesaj letre *[Emri i Ofertuesit /Anetari Kryesues i Bashkimit te Perkohshem]* dhe cdo anetar i *Bashkimit te Perkohshem* (kur është rasti)

- (a) nuk i eshte nenshtruar procedurave te falimentimit ose likuidimit;
- (b) nuk eshte denuar per shkelje penale;
- (c) nuk eshte denuar me Vendim te Gjykates se Formes se prere, qe lidhet me aktivitetin profesional;
- (d) kapitalet/asetet nuk po vleresohen nga Zyra e Permbarimit apo ekziston një urdhër sekuestroje për to;
- (e) ka përmbushur të gjitha detyrimet fiskale;
- (f) ka përmbushur të gjitha detyrimet e sigurimeve sociale.

Me respekt

Nenshkrimi i Personit te Autorizuar  
Emri dhe Pozicioni i Nenshkruesit  
Emri i Ofertuesit/Kryesuesit të Bashkimit të Përkohshëm  
Adresa

## **Shtojca 13**

*(shtojce per tu plotesuar nga autoriteti kontraktor)*

### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

- *Bashkëlidhur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike*

**Shtojca 14 – Jo e aplikueshme**

*(shtojce per tu plotesuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVAT E PUNIMEVE**



## **Shtojca 15**

[ Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

### **NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të koncesionit/partneritetit publik privat. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin për Prokurimet Publike, nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u [s’kualifikuat] [eliminuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur Ligjin nr.125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” dhe VKM 575, date 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”. gjatë procedurës së koncesionit/ppp, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Ligjin“Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” .

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të koncesionit/ppp-ve.

Me respekt

< **Emri** >

## Shtojca 16

[ Shtojce per tu plotesuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data \_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e koncesionit/partneritetin publik privat

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

1. \_\_\_\_\_ Vlera (me numra dhe fjale)

2. \_\_\_\_\_ Vlera (me numra dhe fjale)

Etj. \_\_\_\_\_ Vlera (me numra dhe fjale)

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

---

---

---

---

\* \* \*

(Autoriteti Kontraktues) lajmëron [emri dhe adresa e Ofertuesit fitues] se oferta e paraqitur më datë [data] për marrjen me koncesion te [emri dhe përshkrimi i përgjithshëm i objektit te kontrates] është pranuar.

Afati i negociimit te Kontrates tuaj do te jete \_\_\_\_\_

Ofertuesi [emri] kërkohet t'i paraqesë (Autoriteti Kontraktues) dokumentet e meposhtme:

Y Kopjen e vënies në dijeni për Formularin e Kushteve te Pergjithshme dhe te Vecanta te Kontratës Koncesionare\Partneritetit publik Privat, të nënshkruar.

Y Sigurimin e Kontrates sipas formes se kerkuar ne Dokumentat Standarte te Procedures Konkurruese. Sigurimi duhet te paraqitet jo me vone se ne momentin e nenshkrimit te Kontrates nga te dy palet.

Y Dokument bankar qe verteton pagesen e kryer per shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e konsulences se specializuar (*ne rast se ka*). Kjo pagese do te kryhet para fillimit te negociatave.

Y Ne rast se terhiqeni nga lidhja e kontrates duhet te njoftoni me shkrim.

..... *Autoriteti kontraktues*

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Drejtuesi i Autoritetit Kontraktor]

## **Shtojca 17**

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS**

- *Bashkëlidhur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike*

## Shtojca 18

[ Për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### KUSHTET E VEÇANTA (DRAFT KONTRATA)

- *Bashkëlidhur në Sistemin e Prokurimeve Elektronike*

#### Punët

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë ato të Kushteve të Përgjithshme.

#### Neni 1: Përkufizime

|    |             |            |       |
|----|-------------|------------|-------|
| 1. | Autoriteti  | Kontraktor | është |
| 2. | Kontraktori |            | është |

#### Neni 2: Sigurimi i Kontrates

1. Sigurimi i kontrates në shumën 5% duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
2. Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm:

#### Neni 3: Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor

1. Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor:
2. Adresa/pika e kontaktit: \_\_\_\_\_

#### Neni 4: Kantieri

- 4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i sakte i venddodhjes së objektit që do të realizohet):

#### Neni 5: Data e Fillimit

- 5.1 Kjo kontratë:

#### Neni 6: Lloji i Kontratës

---

## **Shtojca 19 (Draft)**

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

[ *Shtojce per tu paraqitur nga Operatori Ekonomik*]

### **FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS**

[Data\_\_\_\_\_]

Për : [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emer të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

Procedura e koncesionit/ ppp: [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: (*objekti*)

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimit Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

#### Duke gene se:

- (*emri i Ofertuesit Fitues*) eshte shpallur fitues ne Proceduren Konkurruese per Marrjen me Koncesion/PPP te\_\_\_\_\_, me vendndodhje ne , sipas shkreses se (emri i Autoritetit Kontraktor) (me poshte referuar si "Autoriteti Kontraktor"), Nr\_ Prot, date, "Njoftimi i Fituesit" ; dhe
- Ofertuesi Fitues ka paraqitur prane nesh Draftin e Kontrates te lidhur ndermjet tij dhe Autoritetit Kontraktor, "Per marrjen me koncesion/ppp te\_\_\_\_\_; dhe
- ne Kontraten tuaj kerkohet leshimi i nje Sigurimi Kontrate ne vleren e specifikuar si me poshte, si garanci per permbushjen e detyrimeve te Koncesionarit te parashikuara ne Kontrate; dhe
- (*emri i Bankes/i shoqerise se sigurimit*) eshte dakord te leshoje kete garanci.

#### Deklarojme se:

- jemi garantuesit e kontrates se siperpermendur deri ne shumën totale prej (*shuma ne shifer dhe fjale*), shume e cila është e pagueshme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate ; dhe
- marrim persiper te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej (*shuma e garancise*); dhe
- per marrjen e kesaj garancie, nuk eshte nevoja t'i drejtoheni me pare Koncesionarit\Partneritetit Publik Privat per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj; dhe
- asnje shtesë apo ndryshim i kushteve te Kontrates, per te cilen ju mund te bini dakord me Koncesionarin, nuk na cliron nga detyrimet e kesaj Garancie.

Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne daten qe perfshin\_\_\_\_\_dite nga data e leshimit te Certifikates se Perfundimit.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimeve]

## Shtojca 20 (Draft)

[ Shtojce per tu plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I PUBLIKIMIT TE NJOFTIMIT TE KONTRATËS SE NËNSHKRUAR

#### I. Autoriteti Kontraktor

##### I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Adresa në Internet \_\_\_\_\_

##### I.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

|                              |                          |
|------------------------------|--------------------------|
| Institucion qendror          | Institucion i pavarur    |
| <input type="checkbox"/>     | <input type="checkbox"/> |
| Njesite e Qeverisjes Vendore | Tjetër                   |
| <input type="checkbox"/>     | <input type="checkbox"/> |

#### II. Objekti i Kontratës

##### II.1 Lloji i Kontratës

|                          |                          |
|--------------------------|--------------------------|
| Punë                     | Shërbime                 |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |

##### II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës

1. Objekti i kontratës \_\_\_\_\_
2. Forma e Kontratës \_\_\_\_\_
3. Burimi i Financimit \_\_\_\_\_



**II.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:**

Kohëzgjatja në muaj \_\_\_ ose ditë \_\_\_\_\_

ose

duke filluar nga \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_ me përfundim në \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_

**III. Procedura**

**III.1 Lloji i procedurës:**

|         |            |   |
|---------|------------|---|
| E hapur | E kufizuar | Me negociim<br>me shpallje<br>paraprake |
|---------|------------|---|

**III.2 Numri i ofertave të dorëzuara: . . .**

**III.3 Numri i ofertave të rregullta: \_\_\_\_\_**

**IV. Informacion mbi kontratën**

**IV.1 Numri i Kontratës: \_\_\_\_\_**

**Data e Kontratës \_\_\_/\_\_\_/\_\_\_**

**IV.2 Emri dhe adresa e kontraktorit**

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Tel/Fax \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

Adresa e Internetit \_\_\_\_\_

**IV.3 Vlera Totale**

Vlera \_\_\_\_\_ (pa TVSH)

Monedha \_\_\_\_\_

**IV.4 Informacione shtesë (nëse ka)**

---

---

---

---

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi \_\_/\_\_/\_\_\_\_\_

**Shtojca 21 (Draft)**

**FORMULARI I ANKESËS PRANE AUTORITETIT  
KONTRAKTOR**

*Ankesë drejtuar : Autoriteti Kontraktor*

**Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (psh, si individ, në partneritet, në bashkëpunim, në bashkim shoqëror).*

---

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

---

Adresa

---

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Kodi Zip

---

Nr. Telefoni (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

---

Nr. Faksi (duke përfshirë edhe prefiksin e zonës)

---

E-mail

---

Emri dhe pozicioni i zyrtarit të autorizuar që plotëson ankesën (ju lutem, shtypeni)

---

Firma e zyrtarit të autorizuar

---

Data (viti/muaji/dita)

---

Nr. Telefoni (duke përfshirë prefiksin e zonës)

---

Nr. Faksi (duke përfshirë prefiksin e zonës)

## **Seksioni II. Informacion për Procedurën**

### **1. Numër Identifikimi**

*Plotësoni numrin e kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentat e tenderit, duke përfshirë llojin e procedurës së përdorur për koncesionin/ppp në fjalë (psh, Kërkesë për Propozime(KP), Procedurë e Hapur(PH), Procedurë e Kufizuar (PK), Procedurë me Negociim me shpallje paraprake (PN), ).*

### **2. Autoriteti Kontraktor**

*Emri i autoritetit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

### **3. Vlera e Përlllogaritur e Koncesionit/PPP**

*Llogaritja e vlerës së kontratës (shuma e shprehur në shifra dhe fjalë)*

---

### **4. Objekti i Kontratës**

*Përshkrim i shkurtër i punëve/ shërbimeve që blihen.*

### **5. Afati Përfundimtar për Dorëzimin e Ofertës**

*Afati përfundimtar për dorëzimin e ofertave.*

---

### **6. Data e Përcaktimit të Kontratës Fituese**

---

## **Seksioni III. Përshkrimi i ankesës**

### **1. Baza Ligjore e Ankesës**

*(shkruani shkeljen ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumenta, etj)*

## 2. Deklaratë e Hollësishme e Fakteve dhe Argumenteve

*Jepni një deklaratë të hollësishme të fakteve dhe argumenteve që mbështesin ankesën tuaj. Për çdo arsye të ankesës specifikoni datën në të cilën u vutë në dijeni për faktet e lidhura me arsyet e ankesës. Përmendni edhe seksionet përkatëse të dokumentave të tenderit, nëse zbatohen. Përdorni faqe shtesë, nëse është e nevojshme.*

## 3. Lista e Shtojcave

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë.*

*Mundësisht bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të publikuar, të gjitha dokumentat e tenderit, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj.** Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për koncesionin/ ppp, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë **autoritetit kontraktor**

## 4. Kundërshtimi Paraprak ndaj Autoritetit Kontraktues

*Kundërshtim quhet një ankesë e drejtuar drejtpërdrejt autoritetit kontraktues. Bashkangjisni një kopje të çdo ankese me shkrim, duke përfshirë edhe përgjigjen, nëse ka një tillë.*

1. Keni bërë ndonjë kundërshtim të tillë? Nëse po, atëherë specifikoni mënyrën e kundërshtimit (psh, me shkrim, nepermjet faksit, etj).

**Po**  **Jo**

2. Autoriteti Kontraktues Pranë të Cilit është bërë Kundërshtimi  
*Emri i autoritetit kontraktues.*

\_\_\_\_\_  
*Emri dhe pozicioni i zyrtarit ndaj të cilit është bërë kundërshtimi.*

3. Natyra e Masës së Kërkuar Korrigjuese  
*Çfarë mase korrigjuese kërkon?*

4. Lista

*Që një ankesë të konsiderohet e dorëzuar, ajo duhet të jetë e plotë. Bashkangjisni një kopje të lexueshme të të gjithë dokumentave që kanë lidhje me ankesën tuaj dhe një listë të të gjithë këtyre dokumentave. Dokumentat duhet të përfshijnë normalisht **çdo njoftim të***

*publikuar, të gjitha dokumentat e procedures konkurruese, me të gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj; të gjithë korrespondencën dhe çdo informacion me shkrim që lidhet me një kundërshtim që keni bërë. Përcaktoni se cili prej informacioneve është konfidencial, nëse ka të tillë. Shpjegoni se përse informacioni është i tillë, ose dorëzoni një version të dokumentave përkatëse me pjesët konfidenciale të hequra dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës për konkurimin, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtesë, pranë: **Autoriteti perkates sipas ligjit nr. 125/2013 “Per koncensionet dhe partneritetin publik privat”**

**Nr. Faks:**

**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit**

Shënim: Për ankesat pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari të Ankesës se nxjerrë nga ky institucion.

**Nr. Faks:**

**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e Ankuesit**

## Shtojca 22

[Shtojce per tu plotesuar nga Operatori Ekonomik]  
**FORMULARI I PROKURËS**

### **PROKURË**

Sot më datë, muaji, viti .....

Perpara meje

Noterit/es

I/E nenshkruari/a

z./zj. \_  
ne cilesine e tij/saj \_\_\_\_\_

Shtetesia \_\_\_\_\_

Mbajtes i Pasaportes ose Dokumentit te Identifikimit nr. Leshuar  
nga \_\_

Me date \_\_\_\_\_

Banues ne \_\_\_\_\_

Emeroj z./zj. \_\_\_\_\_ ne cilesine e tij/saj si \_\_\_\_\_, per te:

- (a) nenshkruar ose vulosur dhe per te dorezuar tek autoritetet kompetente te gjithë dokumentet e renditura ne Pasqyrën 1 bashkelidhur;
- (b) dorezuar dhe marre ne dorezim cdo lloj dokumenti apo instrumenti ne lidhje me dokumentet e renditura në Pasqyrën 1 bashkelidhur; dhe
- (c) Te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme ose shtese ne lidhje me ceshtjet e percaktuara ne kete dokument, perfshire edhe nenshkrimin dhe zbatimin e cdo akti, i cili nevojitet per te zbatuar per te plotesuar dokumentet e listuar ne Pasqyrën 1, ose qe keto dokumente te sjellin pasoja.

Dhe eshte i/e autorizuar te emeroje persona te tjere per te ushtruar te gjitha ose nje pjese te tagrave te percaktuara ne kete Prokure